




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCE PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	
Dep.	<u>2-D/DPK</u>
Dep.	
Nr. i faq	
Broj stranica	
Nr. pages	<u>62</u>
Nr. Prot.	
Br. Prot.	
Prot No.	<u>01-4593/14</u>
Data	
Datum	
Dan	
04.12.2014	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCE PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragafi 1.1), nenit 5 (paragafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit si dhe nenit 19 (paragafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korruptionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korruptionit me datë 02.12.2014, mori:

V E N D I M

I. Mylllet rasti me nr. AKK-03-3481/14, për z. Fitim Mustafa u.d. Drejtor në Ministrinë e Integrimeve Evropiane, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme te konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I . Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-3481/14,qe për trajtim ka pas zyrtarin e lartë z. Fitim Mustafa, u.d. Drejtor në Ministrinë e Integrimeve Evropiane.

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari i lartë, gjatë kohës se ushtrimit të funksionit publik si, u.d. i Drejtorisë në Ministrin e Integrimeve Evropiane është identifikuar si pronar dhe person i autorizuar, në një biznes privat e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin te funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korruptionit me datën 16.10.2014. e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas kësaj shkresë z. Fitim Mustafa, është përgjigjur shkresës paralajmëruese dhe ka ardhur ne AKK, me datën 23.10.2014 ku është njoftuar nga zyrtaret e AKK-se, për faktet qe disponon Agjencia lidhur me dyshimin për Konflikt te mundshëm te interesit.

z. Fitim Mustafa , gjatë takimit është pajtuar me gjendjen, mirëpo ka dëshmuar se biznesi nuk zhvillon aktivitet, qe sa vite dhe ka menduar qe është shuar, por është zotuar se në afat sa me të shpejt do te bej ndryshimet e nevojshme dhe do te shmanget nga situata e mundshme e konfliktit të interesit.

Me datën 25.11.2014, z. Fitim Mustafa, ka sjell ne AKK-ë dokumentet zyrtare te lëshuar nga ARBK-ja ku dëshmohet se janë ber ndryshimet dhe se biznesi me nr. 70270342 dhe emër L.Z. "La Vita Nostra" – është shuar, asgjësuar ne mënyrë vullnetare nga zyrtari.

Vlerësojmë se zyrtari i lartë publik z. Fitim Mustafa, me shuarjen vullnetare te biznesit ka shmangur gjendjen e mundshme te konfliktit të interesit në të cilën ndodhej, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L.-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

